



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.01.2021, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14 dhjetor 2020.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit dhe programit të punës për datat 18 janar–4 shkurt 2021.
3. Projektligji “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), për krijimin e një përfaqësie të FAO-s në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Eglantina Gjermeni, Ervin Bushati, Andrea Marto, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Ditmir Bushati, Ligoraq Karamelo, Reme Lala

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Halit Valteri dhe Fatmir Velaj.

Të ftuar:

Ermira Gjeci - Zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Enea Hoti - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita, të gjithëve!

Fillojmë sot mbledhjen e parë për këtë vit të Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 20 janar 2021.

Ju uroj sesion të mbarë, kolegë dhe kolege deputetë!

Në rendin e ditës së sotme kemi:

Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 14 dhjetor të vitit të kaluar;

Miratimin e kalendarit të punës së komisionit për datat 18 janar - 5 shkurt, si dhe programin nga data 18 janar-26 shkurt 2021;

Diskutimin e projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për ushqimin dhe bujqësinë, FAO, për krijimin e një përfaqësie të FAO-s në Republikën e Shqipërisë”. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Marto. Të ftuar kemi zonjën Gjeci, zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Mirë se vjen në komision, zonja Zëvendësministre!

Punë të mbarë!

Kuorumi është i plotësuar.

Bashkë me mua është edhe kolegia Gjebrea.

Mendoj të fillojmë pa humbur kohë.

A ka vërejtje për procesverbalin e mbledhjes së fundit? Nuk ka.

Kush është dakord? Të gjithë dakord.

Kalojmë në miratimin e kalendarit të punës për datat 18 janar - 5 shkurt dhe programin e datave 18janar - 26 shkurt.

Nëse jeni dakord, e konsideroj të miratuar kalendarin e punës dhe programin.

Pa humbur kohë, vazhdojmë me diskutimin e projektligjit.

Fillimisht do t’ia jap fjalën zonjës Gjeci. Më pas do të relatojë kolegu Marto dhe do të vijojmë me pyetjet dhe diskutimet para votimit.

Zonja Gjeci, fjala për ju!

Ermira Gjeci – Faleminderit!

E nderuar, kryetare e komisionit,

Të nderuar, anëtarë të komisionit,

Ky projektligj ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe FAO-s, Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë.

Kjo marrëveshje është nënshkruar pas miratimit në parim, me vendimin nr. 800 të Këshillit të Ministrave, datë 26 nëntor 2014 “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, FAO, për krijimin e një përfaqësie të FAO-s në Republikën e Shqipërisë”. Pra, ratifikimi i marrëveshjes synon finalizimin e procedurës së nisur.

Ky projektligj është në përputhje dhe në zbatim të programit politik të qeverisë shqiptare për zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje mbështetet në ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjen ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”; është detyrim ligjor dhe bën të mundur përfundimin e procesit sipas legjislacionit në fuqi, konkretisht pas miratimit në parim, që është akti, me anën e të cilit Këshilli i Ministrave ka miratuar projektin e marrëveshjeve të paraqitura nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, sot Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: paranënshkrimi.

Pas miratimit në parim dhe me vendimin nr. 800 të Këshillit të Ministrave, datë 26.11.2014 “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe/me Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, FAO, për krijimin e një përfaqësie të FAO-s në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshja është nënshkruar nga palët. Kështu, bazuar në nenin 17, të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për të realizuar përfundimin e këtij procesi, të paraqesim për miratim propozimin për ratifikimin e marrëveshjes në fjalë.

Projektmarrëveshja përcillet për miratim në vitin 2020 me synimin e përfundimit të procesit, i cili ka nisur në vitin 2015 dhe ratifikimi i saj plotëson përfundimin e të gjithë procedurës.

Theksojmë se FAO ka kryer aktivitete në përputhje me marrëveshjen dhe ka dhënë një kontribut të vlefshëm, i cili do të shtohet në volum dhe në cilësi në vijim me projekte ndihmëse në disa sektorë, siç janë: programe në bujqësi, ushqim dhe asistencë në miratimin e akteve që përafrojnë legjislacionin.

Përfitimet e palës shqiptare nga kjo marrëveshje janë zbatimi i projekteve të financuara, duke u bazuar në strategjinë ndërsektoriale për bujqësinë dhe për zhvillimin rural në Shqipëri gjatë viteve 2014–2019. Kjo strategji përfaqëson kornizën kryesore strategjike

sektoriale për ndërhyrjet operacionale kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u përqendruar në tri fushat kryesore të politikës së zhvillimit rural, skemat kombëtare të mbështetjes dhe të zhvillimit institucional, si dhe zbatimin e kërkesave rregullatore të Bashkimit Europian.

Në dy vitet e fundit FAO, duke u bazuar në “*Country program framework*”, ka implementuar dhe është në proces implementimi të projekteve në këto fusha kryesore:

- në zhvillimin e fermerëve të vegjël;
- në rritjen e kapaciteteve institucionale për t’u ardhur në ndihmë fermerëve.

Në kuadër të këtij objekti, FAO ka implementuar dhe vazhdon të implementojë këto projekte:

- mbështetje për forcimin e fermerëve të vegjël me një buxhet 260 mijë dollarë;
- zhvillimin e kapaciteteve për diversifikimin e të ardhurave për fermerët e vegjël me një buxhet 160 mijë dollarë;

- projekti “*Gray gender ruraly, quality and territorial*” në bashkëpunim me UEN

- mbështetje për ripërtëritjen ekonomike nga tërmeti i 26-nëntorit, me një buxhet 500 mijë dollarë;

- asistencë teknike e Ministrisë së Bujqësisë me projektet e mëposhtme:

- ndërtimi i kapaciteteve të ministrisë për të asistuar në negociata teknike me ju në bujqësi dhe në zhvillimin rural, me një buxhet 450 mijë dollarë;

- projekti “*Forward*”, me një buxhet prej 350 mijë dollarë;

- asistencë në ndërtimin e një dritareje unike në shërbim të fermerëve dhe në shërbimin e ekstensionit, me një buxhet prej 50 mijë dollarësh;

- për ndryshimet klimaterike dhe bujqësia, projekti i menaxhimit të burimeve natyrore në luginën e Vjosës, me një buxhet rreth 100 mijë dollarë.

Ky projektligj mbështetet në nenin 121 të Kushtetutës, në nenin 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe është në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Nuk synon përfrimin me *aqui*-në e BE-së.

Institucionet që kanë kontribuar janë: Ministria e Bujqësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

Miratimi i këtij projektligji nuk do të ketë efekte financiare në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, por zbatimi i tij synon të sjellë të ardhura të pritshme financiare.

Pas miratimit të projekteve të reja dhe zgjerimit të aktivitetit të FAO-s në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, do të miratohen edhe projektaktet përkatëse, ku do të pasqyrohen dhe efektet financiare.

FAO është një nga agjencitë e UEN-it dhe kjo marrëveshje i nënshtrohet të gjitha kushteve që përcaktohen në marrëveshjet që lidhen me të gjitha agjencitë e UEN-it.

Zyra aktuale e FAO-s në Shqipëri është vetëm një zyrë vendore, që i përket vendit, quhet “Zyra e FAO-s” në Shqipëri dhe nëpërmjet kësaj marrëveshjeje qëllimi është krijimi i një zyre rajonale të FAO-s, çka do të sjellë për Shqipërinë më shumë benefite në volum, pasi do të ketë mundësi të ketë akses në fonde rajonale, por edhe në fonde globale, gjithmonë me fokus zhvillimin e bujqësisë.

Ka pasur një shkëputje të finalizimit të procesit, që nga viti 2015. Dy duhet të ishin iniciativat, të cilat duhet të përfundonin të gjithë procesin: ose iniciativa e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, ose e Ministrisë së Bujqësisë. Ndërkohë, Ministria e Bujqësisë e mori iniciativën para dy vjetësh për finalizimin e të gjithë këtij procesi, duke arritur në ditën e sotme, në këtë fazë ku jemi, duke ardhur në komisionin tuaj për të marrë aprovimin e këtij projektakti.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zëvendësministre!

Koleg Marto, fjala për ju.

Faleminderit!

Andrea Marto – Faleminderit, zonja kryetare!

Siç e dëgjuat dhe ju, zëvendësministrja ishte shteruese, i trajtoi të gjitha çështjet që lidhen me këtë marrëveshje dhe bashkëpunimin që kemi me organizatën në fjalë.

Fushat kryesore, siç u theksua dhe nga zëvendësministrja, janë ndihma konkrete me projekte për fermerët e vegjël; asistencë teknike për të ndihmuar ministrinë në rritjen e kapaciteteve, gjë që është e domosdoshme në këtë situatë ku është vendi ynë dhe me përpjekjet për t’u integruar në Bashkimin Europian, pra nevojitet rritje e kapaciteteve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe ndihma e vazhdueshme që ka dhënë kjo organizatë në rastet e fatkeqësive natyrore.

Formalisht, ratifikimi i kësaj marrëveshjeje është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit. Për rrjedhojë, i ftoj të gjithë kolegët ta votojmë njëzëri ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, Andrea!

Shikoj nënkryetarin Gjoni, që po kërkon fjalën. Fjala për ju.

Ralf Gjoni – Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje të gjithë kolegëve!

Faleminderit, zëvendësministre Gjeci!

Kam vetëm një pyetje shumë të thjeshtë. Patjetër, në parim jam dakord me kolegun Marto, që duhet të ratifikojmë, madje duhet ta kishim ratifikuar me kohë, por kam vetëm një pyetje për kuriozitet (ndoshta e kam gabim pyetjen): pse janë dashur 5-6 vjet për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje? Në fund të fundit, marrëveshja është nënshkruar në vitin 2014, zyra e përfaqësuesit ekziston në Shqipëri, madje ka dhe një emër, dhe aktivitetet vazhdojnë konform ligjit. Pse nuk e kemi ratifikuar më parë? Është harruar apo ka qenë e qëllimshme?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, nënkryetar!

A ka pyetje të tjera?

Zëvendësministre, fjala për ju.

Ermira Gjeci – Faleminderit për pyetjen!

E preka përciptazi: në mënyrë që të vazhdohej e gjithë procedura, dy kanë qenë institucionet e ngarkuara, ose Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, ose Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Asnjëra nuk e ka marrë iniciativën, deri para dy vjetësh. Kështu që Ministria e Bujqësisë mori iniciativën për vazhdimin dhe përfundimin e kësaj procedure, e cila ka veçse benefite për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, por edhe për të gjithë vendin.

Nuk e di nëse ishte shteruese. Mbase sekretari i Përgjithshëm, i cili është panel, do të dojë të shtojë diçka.

Mimi Kodheli – Zoti Hoti, fjala për ju.

Enea Hoti – Faleminderit!

Thjesht për qartësim, marrëveshja është miratuar në parim në vitin 2014 dhe, deri në vitin 2016, kur është miratuar ligji i ri për traktatet ndërkombëtare, nr.43/2016, detyrimi për ta çuar marrëveshjen për ratifikim ka qenë i Ministrisë së Jashtme. Me hyrjen në fuqi të ligjit të vitit 2016, ky detyrim iu la ministrive propozuese të aktit, në këtë rast Ministrisë së Bujqësisë. Kjo praktikë, po themi, 10-15-vjeçare, që i çonte më parë për ratifikim Ministria e Jashtme, ka shkaktuar këtë vonesë, deri sa u kuptua që tani duhet ta çonte Ministria e Bujqësisë, me ligjin e ri të vitit 2016.

Ndërkohë, nuk është vënë re, sepse, siç e tha dhe deputeti, zoti Gjoni, zyra ka funksionuar. Për FAO-n, miratimi në parim me VKM ka qenë i vlefshëm dhe normalisht ata

kanë filluar, por për sistemin e brendshëm të Shqipërisë, për ta përmbyllur procesin, duhet që marrëveshja të ratifikohet me ligj në parlament. Kështu që ky ka qenë keqkuptimi. Ndërkohë, kanë ndryshuar 3 apo 4 administrata deri sot që flasim dhe ndoshta nuk kanë qenë korrekte dhe nuk e kemi kapur në kohë, sepse zyra ka funksionuar. Ky ka qenë një detaj teknik, jo se ka pasur ndonjë qëllim mbrapa.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Hoti!

A ka pyetje dhe diskutime të tjera?

Zonja Gjermani, fjala për ju.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit për shpjegimet, zonja zëvendësministre dhe zoti sekretar i Përgjithshëm! Doja të dija se cili do të jetë impakti dhe si do të ndikojë ratifikimi i kësaj marrëveshjeje apo kalimi i këtij projektligji në parlament dhe sa do të ndikojë në zhvillimin e bujqësisë apo në projektet që ministria do të vazhdojë të ketë në bashkëpunim me FAO-n?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zëvendësministre, fjala për ju.

Ermira Gjeci – Atëherë, nga një përfaqësi vetëm në Shqipëri, kalojmë në një zyrë rajonale; rrit nivelin e përfaqësimit; marrëdhënia shkon në një nivel më të lartë. Është një marrëdhënie më serioze dhe patjetër që zyra përforcohet dhe lejon mundësinë e përthithjes më shumë të fondeve ose të projekteve, të cilat synojnë zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Mimi Kodheli – Dakord.

Shikoj që nuk ka pyetje apo komente të tjera. Mendoj ta kalojmë në votim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Shikoj që jemi të gjithë dakord. Nuk është e nevojshme të përmend emrat.

Faleminderit!

Neni 1. Kush është dakord? Shikoj që jemi të gjithë dakord. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Jemi të gjithë dakord. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Projektligji konsiderohet i miratuar.

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Faleminderit, sekretar i Përgjithshëm!

Kolegë, faleminderit për prezencën!

Do të njoftoheni në vazhdim, por besoj se do të jetë të premtën, në orën 10:30, diskutimi i projektligjit për fondet IPA. Kështu që merrni masat për prezencën tuaj.

Po, Ralf.

Ralf Gjoni – Kryetare, faleminderit!

Kam një pyetje: do të kalojë marrëveshja e Pfizer-it në Komisionin e Jashtëm? Kur do të kemi akses ne, si deputetë? A ka ndonjë informacion për sa i përket aksesit që ne, si deputetë, duhet të kemi ndaj tekstit të marrëveshjes?

Mimi Kodheli – Unë besoj se do të na mundësohet akses neve, si deputetë (flas në përgjithësi, jo vetëm për komisionin), për t'u njohur me tekstin e marrëveshjes dhe ndërkohë ka kaluar si marrëveshje herën e fundit që kemi pasur seancë. Kështu që...

Ralf Gjoni – E di, por në seancë kërkova të na vihej në dispozicion teksti dhe Kryetari i Kuvendit shpjegoi që nëpër komisionet relevante do të kemi akses si deputetë, pavarësisht se...

Mimi Kodheli – Informacioni që unë kam është i njëjtë, që ne do ta na mundësohet njohja me tekstin e marrëveshjes. Kështu që besoj se me një interesim të dytë do të kuptojmë se kur do të jetë e mundur kjo.

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ditë të mbarë!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA